

20150100166

**LIGJ PËR PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR HUAMARRJE TË REPUBLIKËS SË  
MAQEDONISË TE BANKA EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM SIPAS  
MARRËVESHJES PËR HUA PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT "NDËRTIMI I  
SEGMENTIT TË RI DHE RIKONSTRUKTIMI I SEGMENTIT EKZISTUES  
BELAKOVÇ-KRIVA PALLANKË - PJESA LINDORE E HEKURUDHËS SË  
KORRIDORIT VIII, FAZA 2"**

Neni 1

Në Ligjin për huamarrje të Republikës së Maqedonisë te Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim sipas Marrëveshjes për hua për financimin e Projektit "Ndërtimi i segmentit të ri dhe rikonstruktimi i segmentit ekzistues Belakovç-Kriva Pallankë - pjesa lindore e hekurudhës së Korridorit VIII, faza 2" ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 178/14), pas nenit 7 shtohet neni i ri 7-a, si vijon:

"Neni 7-a

Qarkullimi i të mirave dhe shërbimeve i kryer ndaj Ndërmarrjes Publike për Infrastrukturë Hekurudhore "Hekurudhat e Maqedonisë" - Shkup, të dedikuara për realizimin e Projektit "Ndërtimi i segmentit të ri dhe rikonstruktimi i segmentit ekzistues Belakovç-Kriva Pallankë - pjesa lindore e hekurudhës së Korridorit VIII, faza 2", të financuar me Marrëveshje për hua nga neni 1 i këtij ligji lirohet nga tatimi mbi vlerën e shtuar me të drejtën e heqjes së tatimit paraprak.

Importi i të mirave/shërbimeve nga Ndërmarrja Publike për Infrastrukturë Hekurudhore "Hekurudhat e Maqedonisë" - Shkup, të dedikuara për realizimin e Projektit "Ndërtimi i segmentit të ri dhe rikonstruktimi i segmentit ekzistues Belakovç-Kriva Pallankë - pjesa lindore e hekurudhës së Korridorit VIII, faza 2", të financuar me Marrëveshje për hua nga neni 1 i këtij ligji, lirohet nga tatimi mbi vlerën e shtuar dhe detyrime tatimore, si dhe nga akciza gjatë importit të automobilave dhe vajrave minerale.

Për qarkullimin e kryer ndaj Ndërmarrjes Publike për Infrastrukturë Hekurudhore "Hekurudhat e Maqedonisë" - Shkup, të dedikuara për realizimin e Projektit "Ndërtimi i segmentit të ri dhe rikonstruktimi i segmentit ekzistues Belakovç-Kriva Pallankë - pjesa lindore e hekurudhës së Korridorit VIII, faza 2", të financuar me Marrëveshje për hua nga neni 1 i këtij ligji, për të cilin i njëjti është obligues tatimor sipas nenit 32 pika 4 dhe nenit 32-a të Ligjit për tatim mbi vlerën e shtuar, lirohet nga obligimi për llogaritjen dhe pagesën e tatimit mbi vlerën e shtuar.

Obliguesi tatimor që kryen qarkullim të liruar nga tatimi mbi vlerën e shtuar sipas paragrafit (1) të këtij neni, detyrimisht përveç emrit (emërtimit) të pranuesit të së mirës ose shfrytëzuesit të shërbimit, në faturë i shënon edhe emërtimin e projektit edhe emërtimin e Marrëveshjes për hua nga neni 1 i këtij ligji.

Ndërmarrja Publike për Infrastrukturë Hekurudhore "Hekurudhat e Maqedonisë" - Shkup gjatë importit të të mirave të liruara sipas paragrafit (2) të këtij neni, organit kompetent doganor detyrimisht i dorëzon kopje të Marrëveshjes për hua nga neni 1 i këtij ligji dhe deklaratë se të mirat/shërbimet e importuara janë të dedikuara për realizimin e Projektit "Ndërtimi i segmentit të ri dhe rikonstruktimi i segmentit ekzistues Belakovç-Kriva Pallankë - pjesa lindore e hekurudhës së Korridorit VIII, faza 2", të financuar me Marrëveshje për hua nga neni 1 i këtij ligji."

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".